



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:283514
Datë: 17.09.2024
Numri i dokumentit: 06172940

C. nr. 4958/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.M. me numër personal nga Mamusha, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Mamushës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara, vlera e kontestit 671.58 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 17 Shtator 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. MIRATOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses S.M. nga Mamusha, DETYROHET e paditura Komuna e Mamushë-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 deri më datë 31.01.2023 apo për 13 muaj (për çdo muaj shumën prej 51.66 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë 393.00 euro, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej **671.58 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë me datë 15.12.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 euro**, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja S.M. nga Mamusha, përmes të autorizuarit të saj A.H. avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datën 15.12.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mamushës–Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara, vlera e kontestit 671.58 euro.

Në referatin e padisë, pala paditëse ka theksuar se paditësja punon pranë Shkollës fillore "Anadolu" në Mamushë dhe është e licensuar dhe kualifikuar mësimdhënës me titull Baçellor i programit Parashkollor. Meqenëse paditësja është e licensuar dhe e ka kualifikimin e mësimdhënësit në nivelin bachelor me diplomë fakulteti, në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008, përkatësisht nenit 3 të këtij vendimi, të njëjtit i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 27% të pagës bazë, çka e paditura këtë shtesë e

paguan pjesërisht. Padiësja realizon pagën bazë prej 393.00 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 27% e kësaj page apo shuma prej 106.11 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë në shumën prej 54.45 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 51.66 euro, që nga data 01.01.2022 deri në 31.01.2023, për gjithsej 13 muaj në shumën prej 671.58 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e padiësit si të pa bazuar, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se pretendimet e padiësës se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim pasi që në padi padiësja ka theksua edhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 dt.29.08.2008. Andaj me as një nen apo paragraf nuk thekson që Komuna apo Drejtoria Komunale e Arsimit janë të obliguara që ta bëjnë zbatimin e këtij vendimi. Me këtë rast Komuna e Mamushës si palë e paditur në këtë çështje kontestimore e njëjta ka legjitimitet pasiv pasi që e njëjta nuk e ka marrë as një vendim të tillë. Padiësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, pasi që së pari nuk ka paraqitë kërkesë pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit, e me këtë rast padiësja nuk i ka shtjerrë të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative, duke ju drejtuar gjykatën në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Nga të lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e padiësës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e padiësës është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se padiësja S.M. nga Mamusha, është në marrëdhënie pune tek e paditura pranë shkollës fillore "Anadollu" në Mamushë, si mësimdhënëse. Mirëpo, kontestuese ishte nëse padiësës i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër të protokolli 002/18, e datës 01.09.2018, e lidhur ndërmjet padiësës dhe të paditurës, rezulton se padiësja është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse, padiësja ka të kryer Fakultetin e Edukimit dhe me këtë ka marrë titullin Bachelor i programit Parashkollor, e cila vërtetohet përmes diplomës me numër 258 të datës 26.05.2016, të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit. Në bazë të vërtetimit të lëshuara nga e paditura me numër 03 të datës, 15.11.2023, padiësja është mësimdhënëse që nga viti akademik 2016/2017 e cila punonë edhe në institucionin parashkollorë "Zybejde Hanëm" në cilësinë edukatores. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të padiësës është në shumë prej 393.00 euro dhe se padiësës në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 54.45 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *"shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet*

apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumë më prej 51.66 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësi përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumë më prej 106.11 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumë më prej 51.66 euro apo diferencën e mbetur për 13 muaj, nga data 01.01.2022 e deri më datë 31.01.2023, në shumë të përgjithshme prej 671.58 euro (13 x 51.66= 671.58) euro.

Duke marrë për bazë se gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së vendos brenda kërkesës së palëve ndërgjyqëse dhe se paditësja ka kërkuar që kompensimi mbi bazën e kualifikimit apo licencimit të realizohet me pagën bazë prej 393.00 euro, mbi këtë bazë gjykata aprovoi këtë kërkesë të palës paditëse, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (15.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet e palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
C.nr.4958/23, me datë 17 Shtator 2024

B. profesional
Ilir Sërtollaj

Gjyqtari
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.